

DEKRET
Nr.7440, datë 1.12.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7377, DATË 8.5.1990 “PËR BANKËN SHQIPTAR” DHE NË LIGJIN NR.7378, DATË 8.5.1990 “PËR BANKËN BUJQËSORE”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7377, datë 8.5.1990 “Për Bankën e Shtetit Shqiptar” bëhen këto ndryshime:

- Në nenin 2 shkronja “dh” ndryshohet si vijon:

“Përqëndron llogaritë e pagesave e të arkëtimeve të ndërmarrjeve, institucioneve e oranzatave shoqërore, kryen arkëtimet e pagesat dhe bën grumbullimin e mjeteve monetare. Çel llogari për shtetasit që zhvillojnë veprimtari private shërbimi e artizanati”.

- Në nenin 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Banka e Shtetit Shqiptar u jep kredi afatgjatë shtetasve për ndërtimin, përshtatjen, rikonstruksionin dhe pajisjen e lokaleve të shërbimit e të artizanatit”.

Neni 2

Në ligjin nr.7378, datë 8.5.1990 “Për Bankën Bujqësore” bëhen këto ndryshime:

- Në nenin 2 shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“Përqëndron llogaritë e pagesave e të arkëtimeve të ndërmarrjeve e të institucioneve të sistemit të bujqësisë dhe të kooperativave bujqësore, si dhe kryen arkëtimet e pagesat e tyre. Çel llogari për shtetasit që zhvillojnë veprimtari private shërbimi e artizanati”.

- Në nenin 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Banka Bujqësore u jep kredi afatgjatë shtetasve për ndërtimin, përshtatjen, rikonstruksionin dhe pajisjen e lokaleve të shërbimit e të artizanatit”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI SIHAT TOZAJ	KRYETARI RAMIZ ALIA
--	--------------------------------------